

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

# DORACA

PËR EDUKIMIN  
E KËSHILLAVE ZGJEDHORË

ZGJEDHJET 2024

## PËRMBAJTJA:

POROSI NGA KOMISIONI SHETËROR I ZGJEDHJEVE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1. HYRJE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2. STANDARDET DHE RREGULLAT E SJELJES ETIKE TË ADMINISTRATËS ZGJEDHORE .....	5
3. KOMUNIKIM DHE INKLuzion PËR VOTUESIT ME PENGESA .....	5
4. GRUMBULLIM DHE PREZANTIM I TË DHËNAVE TË NDARA SIPAS GJINISË .....	6
4.1. Pse nevojitet statistikë e ndarë sipas gjinive? .....	6
4.2. Në cilat raste mbahet statistikë e ndarë sipas gjinive? .....	7
5. MBROJTJE E TË DHËNAVE PERSONALE .....	8
6. DITA PARA ZGJEDHJEVE .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.1. MBLEDHJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NË DITËN PARA ZGJEDHJEVE .....	9
6.1.1. Obligimet e kryetarit të KZ-së .....	10
6.2. PRANIMI DHE SIGURIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR .....	12
6.3. RREGULLIMI I VENDVOTIMIT .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.4. ZGJEDHËSIT QË VOTOJNË NJË DITË PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE .....	19
6.4.1. Votimi i personave të sëmurë ose të pafuqishëm dhe personave në burg shtëpiak ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Si duhet të veprojë këshilli zgjedhorë në rast se: .....	21
6.5. VOTIMI I PERSONAVE QË GJENDEN NË VUAJTJEN E DËNIMIT ME BURG OSE JANË NË PARABURGIM, PERSONAVE TË ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT DHE PERSONAVE QË GJATË ZGJEDHJEVE JANË NËN KUJDESIN E INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT JASHTËFAMILJAR .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.6. PARA SE TË LARGOHENI NGA VENDVOTIMI: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. DITA E ZGJEDHJEVE .....	26
7.1. PËRGATITJE PARA FILLIMIT TË VOTIMIT .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.2. PERSONA TË CILËT MUND TË JENË TË PRANISHËM NË VENDVOTIM .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.3. VOTIMI .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.4. PROCEDURA E VOTIMIT .....	33
7.5. MËNYRA E PËRDORIMIT TË PAJISJES PËR IDENTIFIKIMIN BIOMETRIKT TË VOTUESVE (PIBV) .....	43
<b>7.5.1. Personi që punon me PIBV .....</b>	<b>43</b>
<b>7.5.2. Kontrollim i funksionalitetit të PIBV-së .....</b>	<b>43</b>
<b>7.5.3. Identifikim me PIBV .....</b>	<b>44</b>
<b>7.5.1. Procedura në rastet kur PIBV nuk është funksionale ose nuk mund të përdoret .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>7.5.5. Përfundimi i votimi .....</b>	<b>46</b>
7.6. KUNDËRSHTIMET NGA VOTUESIT .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

7.7.	VOTIMI I PERSONAVE TË CILËVE JU DUHET NDIHMË.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.8.	MBYLLJA E VENDVOTIMIT .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.9.	NDËRPRERJA E VOTIMIT.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.10.	PËRMBLEDHJA DHE VËRTETIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT .....	51
7.11.	PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
8.	NDALESAT NË VENDVOTIM .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
9.	BASHKËPUNIMI ME POLICINË .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7.PYETJET MË TË SHPESHTA.....		<b>Error! Bookmark not defined.</b>



## **POROSI NGA KOMISIONI SHETËROR I ZGJEDHJEVE**

Të nderuar anëtarë të këshillave zgjedhorë,

Ndërsa po përgatitemi për zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare, në emër të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dëshiroj t'u shpreh falënderim secilit prej jush që e përkushtoni kohën, energjinë dhe ekspertizën tuaj për të shërbyer si shtyllë e procesit tonë demokratik. Përkushtimi juaj në suazat e administratës zgjedhore nuk është vetëm për lavdëratë; ajo është pjesë përbërëse e demokracisë.

Paanshmëria dhe integriteti juaj në punën si dhe respektimi i parimi të drejtësisë dhe transparencës e formojnë gurthemelin e administratës zgjedhore.

Nëpërmjet zellit dhe integritetit tuaj, zëri i çdo qytetari fiton rëndësi dhe vërtetohet forca e demokracisë. Roli juaj mishëron një ndjenjë të thellë përgjegjësie ndaj mirëqenies kolektive të shoqërisë sonë. Çdo fletëvotim, votë e numëruar, është dëshmi për përkushtimin dhe profesionalizmin tuaj.

Në emër të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, shpreh mirënjohjen më të thellë për kontributin tuaj tepër të çmueshëm në procesin zgjedhor. Jam i bindur se bashkërisht do t'i organizojmë dhe do t'i zbatojmë edhe zgjedhjet që pasojnë në atmosferë drejtësie për shprehjen e lirë të vullnetit të qytetarëve.

Me respekt,

KOMISIONI SHETËROR I ZGJEDHJEVE  
KRYETAR  
Prof. Dr. Aleksandar Dashtevski

## 1. HYRJE

Këshilli zgjedhor në mënyrë të drejtëpërdrejtë e zbaton votimin në vendvotim dhe ai është përgjegjës për zbatimin ligjor të zgjedhjeve.

Si anëtar i Këshillit zgjedhor, Ju jeni përfaqësuesi i administratës zgjedhore me të cilin votuesit do të kenë kontakt të drejtëpërdrejtë gjatë kohës së votimit. Ju jeni pasqyra e zgjedhjeve në sytë e opinionit vendas dhe ndërkombëtar. Nga puna Juaj, njohuria dhe zbatimimi i rregullave dhe procedurave të parashikuara do të varet vlefshmëria e procesit zgjedhor dhe vlerësimi për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë.

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme të tregoni nivel të lartë të profesionalizmit dhe integritetit në punën Tuaj gjatë kohës së zbatimit të zgjedhjeve. Kjo vlen për obligimet Tuaja para ditës së votimit (psh. vizita në edukimin e domosdoshëm të organizuar nga ana e komisionit komunal të zgjedhjeve) por edhe për obligimet dhe përgjegjësitë për organizimin në ditën e zgjedhjeve, zbatimin e votimit dhe përmbledhjen e rezultateve pas përfundimit të votimit.

Angazhimi juaj duhet ta sigurojë fshehtësinë e votës për çdo votues, por edhe integritetin, sigurinë, transparencën dhe vijimin e qetë të procesit zgjedhor. Me një fjalë, Ju, me sjelljen tuaj, duhet të kontribuoni që të mbahet niveli i lartë i besimit në procesin zgjedhor.

Obligimi juaj është ti zbatoni procedurat zgjedhore në tërësi. Që ti zbatoni, duhet ti njihni dhe në tërësi dhe në mënyrë konsekuente ti respektoni procedurat e parashikuara me Kodin Zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për këtë qëllim, si përkujtues është përpiluar edhe ky Doracak. Nëse nuk i zbatoni procedurat e parashikuara, i shkelni të drejtat e votuesve, e shkelni integritetin e procesit zgjedhor, i shkelni parimet themelore të demokracisë. Për mosrespektimin e procedurave të parashikuara, janë parashikuar sanksione përkatëse duke filluar me masën për largimin nga organet zgjedhore, dënimet në të holla dhe dënimet me burg për vepra më të rënda kundër zgjedhjeve.

Si anëtar i Këshillit zgjedhor, Ju domosdoshmërisht duhet të merrni pjesë në punëtoritë për edukim të cilat do ti organizojë KSHZ-ja në bashkëpunim me Komisionin komunal zgjedhor. Për pjesëmarrjen tuaj do të merrni certifikatë.

## 2. STANDARDET DHE RREGULLAT E SJELLJES ETIKE TË ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar Kod etik për administratën zgjedhore, të cilin mund ta gjeni në <https://www.sec.mk/politika-za-integritet/>, ndërsa me të cilin përcaktohen standardet dhe rregullat etike të sjelljes së administratës zgjedhore, në të cilën bëjnë pjesë kryetarët, anëtarët dhe zëvendësit e tyre në këshillat zgjedhorë.

Standardet dhe rregullat etike të sjelljes së administratës zgjedhore vlejné për marrëdhëniet me kolegët dhe koleget, me eprorët dhe me palët (qytetarë, kandidatë, përfaqësues të autorizuar, vëzhgues), në vendin e punës, por edhe në jetën private dhe në publik.

Këshilli zgjedhor, gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve i respekton parimet për ligjshmëri, profesionalizëm, paanshmëri, neutralitet politik, integritet, përfaqësim të interesit publik, parandalim të konfliktit të interesave, promovim të vlerave demokratike dhe të drejtat sociale dhe mosdiskriminim.

## 3. KOMUNIKIMI DHE PËRFSHIRJA E VOTUESVE ME PENGESA

Komunikimi efikas është me rëndësi thelbësore për inkurajimin e votuesve me pengesa ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës në mënyrë të pavarur dhe pa hezitim. Për atë qëllim, përmbajuni instruksioneve në vijim për lehtësim të komunikimit fillestar me votuesit me forma të ndryshme të pengesave:

### 1. Vlerësim i nivelit qasjes:

Të punësuarit në seksionet dhe zyrat rajonale të KSHZ-së tanimë kanë informacione për qasjen në vendvotimeve, ndërsa një analizë mbi qasjen është publikuar edhe në <https://ep.sec.mk/pollingStations>. Para ditës së zgjedhjeve, siguroni një ide të përgjithshme rreth qasjes në vendvotimet për të cilat jeni kompetent dhe përgatituni për reagim me kohë dhe zvogëlim të rreziqeve të cilat i sjellin me vete mungesa e qasjes në objekt konkret votimi.

**2. Kanale për komunikim:** gjatë komunikimit me votuesit me pengesa, kini parasysh që Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve tanimë ka vendosur më tepër kanale për komunikim për të arritur deri te votuesit me pengesa, duke përfshirë: ueb faqe të aksesshme, video-linjë telefonike të dedikuar për ndihmë dhe informacione në gjuhën e shenjave, fushatë të aksesshme edukative dhe informative, materiale zgjedhore në dispozicion. Udhëzoni votuesit me pengesa në munëdinë që mund t'i përdorin këto kanale.

**3. Trajnimi:** Në trajnimet kërkoni udhëzime shtesë për komunikim efektiv me votuesit me pengesa, duke përfshirë edhe udhëzime praktike për aftësimin e nevojave të ndryshme.

**4. Materiale zgjedhore:** Në të gjitha vendvotime detyrimisht duhet të përdoren materialet zgjedhore që janë në dispozicion: shabllonët për votim me alfabet të Brajtit, pravanët për votim për personat me pengesa, kufizuesi për nënshkrim në ekstraktet e Listës Zgjedhore, ilustrim me foto të hapave për mënyrën e votimit.

**5. Ndihmë gjatë votimit:** Në çdo moment të jeni të vetëdijshëm se gjatë votimit të ndonjë personi me pengesa të cilit mund t'i duhet ndihmë, patjetër duhet të sigurohet e drejta e votimit të fshehtë dhe në çdo moment të respektohet vullneti i votuesit!

**6. Mekanizëm për informacione kthyesë:** Vendosni mekanizëm për informacione kthyesë për votuesit me pengesë që t'i paraqesin të gjitha problemet lidhur me nivelin e qasjes, ndërsa me të cilat janë përballur gjatë procesit të votimit dhe të ndërmerri veprim të shpejtë që të përgjigjeni ndaj këtyre sfidave dhe të përmirësoni nivelin e qasjes në zgjedhjet e ardhshme.

Duke iu përmbajtur këtyre udhëzimeve dhe duke e pasur prioritet nivelin e qasjes dhe inkluzivitetin, si këshilla zgjedhorë mund të luani rol vital në promovimin e pjesëmarrjes së plotë të votuesve me pengesa në procesin zgjedhor. Secila votë është e rëndësishme!

Ja disa **udhëzime praktike për komunikim me personat me pengesa:**

**Respekt dhe dinjitet:** Trajtoni me respekt dhe dinjitet personat me pengesa. Flisni drejtpërdrejtë me personin, kurse jo me shoqëruesin, asistentin ose interpretuesin e personit me pengesa dhe përdoni fjalor me respekt.

**Pyetni para se të ofroni ndihmë:** Nëse mendoni që ndonjë person me pengesë ka nevojë për ndihmë, çdoherë pyetni para se të ofroni ndihmë. Respektoni pavarësinë dhe autonominë e tyre.

**Kini durim:** komunikimi mund të zgjatë më tepër me individë që janë me pengesa. Bëhuni të durueshëm, jepuni kohë të përgjigjen dhe shmangni tendencën për t'i ndërprerë ose për t'i përfunduar fjalitë e tyre.

**Dëgjim aktiv:** Kushtoni vëmendje të madhe në atë që e thotë personi. Mbani kontakt me sytë dhe pohoni me kokë ose jepni shenja tjera për të demonstruar që jeni duke dëgjuar në mënyrë aktive.

**Flitni qartë dhe ngadalë:** flitni qartë dhe me temp (shpejtësi) të mesëm. Shmangni të përdorni gjuhë të komplikuar ose teknike dhe përsëritni ose riformuloni informacione nëse ka nevojë. Mos e ngritni zërin dhe mos bërtitni.

**Përdorni komunikim joverbal:** përdorni gjeste, shprehje të fytyrës dhe shenja tjera joverbale për të përmirësuar komunikimin, veçanërisht për personat me shqisë të dëmtuar të dëgjimit ose me pengesa në të folurit.

**Respektoni hapësirën personale:** Respektoni hapësirën personale të individit dhe shmangni të qëndroni tepër afër ose ta prekni pa leje. Shmangni t'i prekni edhe mjetet ndihmëse të cilat i përdorin personat me pengesa trupore.

**Siguroni informacione të shkruara apo vizuele:** nëse është e përshtatshme, siguroni informacione me shkrim ose vizuele, përveç komunikimit verbal. Sipas nevojës përdorni font të madh, alfabetin e Brajtit ose formate tjera në dispozicion.

**Kërkoni informacione kthyes:** Nëse nuk jeni të sigurt si të komunikoni më së miri me person me pengesa, mos hezitoni të kërkoni informacion kthyes ose udhëzime nga ai person. Ata janë ekspertë për nevojat dhe preferencat e tyre.

## 4. GRUMBULLIMI DHE PREZANTIMI I TË DHËNAVE TË NDARA SIPAS GJINIVE

### 4.1. Pse nevojitet statistikë e ndarë sipas gjinive?

Si pjesë e administratës zgjedhore, është detyrë e yte të mbash statistikë të ndarë sipas gjinive (në disa raste këtë evidencë do ta hasësh me shprehjen: të dhëna të segreguara në bazë gjinore, ose statistikë e ndarë në bazë gjinore).

Përse na nevojitet statistikë e ndarë sipas gjinive?

Të dhënat e ndara sipas gjinisë kanë të bëjnë me të dhënat që kategorizohen dhe analizohen veçmas për pjesëtarët e gjinisë mashkullore dhe gjinisë femërore. Ekzistojnë disa shkaqe pse të dhënat e segreguara në këtë mënyrë duhet të grumbullohen dhe mund të përdoren:

1. Identifikim i dallimeve: Të dhënat e segreguara sipas gjinive mund të ndihmojnë të identifikohen dallimet dhe pabarazitë ndërmjet gjinive në aspekte të ndryshme të zgjedhjeve: kandidimi, vëzhgimi, fushata zgjedhore, edukimi etj. Me analizë të këtyre të dhënave, më mirë mund ta kuptojmë ku dhe si ekzistojnë këto dallime dhe të punojmë në drejtim të zgjidhjes së tyre.
2. Zhvillim i politikave: Të dhënat e segreguara sipas gjinive janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin dhe evaluimin e politikave të orientuara drejt promovimit të barazisë gjinore dhe zgjidhjes së çështjeve gjinore. Reformat në zgjedhjet dhe legjislacionin zgjedhor mund të jenë më efikase kur bazohen në informacione të sakta specifike për gjininë.
3. Shpërndarja e resurseve: Të dhënat e segreguara sipas gjinive na ndihmojnë t'i shpërndajmë resurset në mënyrë të targetuar, duke u siguruar që nevojat dhe sfidat me të cilat përballen gjinitë e ndryshme janë të adresuara në mënyrën përkatëse.
4. Sjellja e votuesve: Të dhënat e segreguara sipas gjinive mund të sigurojnë pasqyrë në lidhje sjelljen e votuesve (dalja e tyre në zgjedhje, interesimi për pjesëmarrje etj).
5. Planifim i edukimit të votuesve: Këto të dhëna mund të na çojnë drejt krijimit të programeve të targetuara për edukim sipas nevojave.
6. Përfaqësim dhe pjesëmarrje: Të dhënat e segreguara sipas gjinive mund të theksojnë përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e meshkujve dhe grave në zgjedhjet, politikë dhe pozitat udhëheqëse. Këto informacione janë të rëndësishme për vlerësimin e progresit drejt barazisë gjinore dhe promovimit të dallimeve.

#### **4.2. Në cilat raste mbahet statistikë e ndarë sipas gjinive?**

Statistikën e ndarë sipas gjinive (femrore dhe mashkullore) këshilli zgjedhor duhet ta mbajë për:

- Përfaqësues-et/it e autorizuar të listave të kandidatëve – meshkuj dhe femra;
- Personat e paraqitur të sëmurë ose të pafuqishëm që kanë votuar një ditë para ditës së zgjedhjeve – meshkuj dhe femra;
- Persona të paraqitur në paraburgim shtëpiak që kanë votuar një ditë para ditës së zgjedhjeve – meshkuj dhe femra;
- Parashtrues(e) të kundërshtimeve për mbrojtjen e të drejtës personale për votim – meshkuj dhe femra;
- Të dhëna për daljen gjatë zgjedhjeve – numri i përgjithshëm i meshkujve që kanë votuar dhe numri i përgjithshëm i femrave që kanë votuar;
- Plotësimi i procesverbalit për përmbledhjen dhe vërtetimin e rezultateve nga zgjedhjet në nivel të komunës (Formulari nr. 16): numri i përgjithshëm i meshkujve që kanë votuar dhe numri i përgjithshëm i femrave që kanë votuar.

**Gjatë parashtrimit të të dhënave në Komisionin Komunal Zgjedhor, përkatësisht Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, doemos dërgoni edhe të dhëna të ndara sipas gjinive.**



## 5. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, Komisioni Komunal Zgjedhor i aplikon parimet lidhur me përpunimin e të dhënave personale që janë përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen të Dhënave Personale, nëpërmjet përpunimit të të dhënave personale në pajtim me udhëzimet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Të dhënat personale:

- ✓ përpunohen në pajtim me ligjin, në mënyrë të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave personale (ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës),
- ✓ grumbullohen për qëllime konkrete, të qarta dhe legjitime (përkufizimi i qëllimeve),
- ✓ përpunohen vetëm të dhënat që janë të përshtatshme, relevante dhe të përkufizuara me atë që është e domosdoshme në lidhje me qëllimet (vëllim minimal i të dhënave),
- ✓ janë gjithmonë të sakta dhe të azhuruara, me ç' rast gjithmonë ndërmerren masa që me kohë të bëhet shlyerja ose korigjimi i tyre, duke i pasur parasysh qëllimet për të cilat janë përpunuara (saktësia),
- ✓ mbahen në formë e cila mundëson identifikimin e subjekteve të të dhënave personale, jo më gjatë nga që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale (përkufizimi i afatit të mbajtjes),
- ✓ përpunohen në mënyrë që siguron nivel adekuat të sigurisë veçanërisht në lidhje me mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar dhe i paligjshëm, si dhe në lidhje me mundësinë për humbjen e tyre, shkatërrimin ose dëmtimin, ndërsa me aplikimin e masave përkatëse teknike dhe organizative (integritet dhe besueshmëri).

Kryetari dhe anëtarët e këshillave zgjedhorë dhe zëvendësit e tyre e kanë për detyrë të nënshkruajnë DEKLARATË PËR SIGURIM TË FSHEHTËSISË DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE. Formularin për këtë deklaratë e marrin nga Komisioni Komunal Zgjedhor dhe pas nënshkrimit, deklaratën e dorëzojnë në KKZ.

## 6. DITA PARA ZGJEDHJEVE

Избирачкиот одбор презема неколку дејствија на денот пред изборите.

QËLLIMI i këtij kreu është ti punojë pikërisht këto veprime:

1. përgatitjen e Këshillit zgjedhor për mbledhje,
2. mbledhjen e Këshillit zgjedhor,
3. ndarjen e roleve (obligimeve) për ditën e zgjedhjeve,
4. pranimin dhe sigurimin e materialit zgjedhor,
5. rregullimin e vendvotimit dhe,
6. zbatimin e votimit për zgjedhësit që janë të sëmurë ose të pafuqishëm ose që janë në burg shtëpiak; dhe
7. zbatimin e votimit për zgjedhësit që gjenden në vuajtjen e dënimit me burg në ndonjërin prej enteve ndëshkimore-korrigjuese.

### 6.1. MBLEDHJA E KËSHILLIT ZGJEDHOR NË DITËN PARA ZGJEDHJEVE

- ✓ Komisioni komunal zgjedhor e njofton kryetarin e Këshillit zgjedhor për kohën e dorëzim-pranimit të materialit zgjedhor.
- ✓ Kryetari i këshillit zgjedhor e njofton zëvendësin e tij dhe anëtarët, për kohën e pranimit të materialit dhe e thërret këshillin zgjedhor të mblidhet para vendvotimit, një orë para pranimit të materialeve

✓ <b>Rekomandohet që këshilli zgjedhor të jetë në përbërje të plotë!</b>
✓ <b>Nëse nuk është prezent anëtari, në punë merr pjesë zëvendësi i tij!</b>

**Kryetari dhe anëtarët e tjerë të Këshillit zgjedhor dakordohen për NDARJEN E ROLEVE (OBLIGIMEVE) në ditën e votimit. Rolet e anëtarëve të Këshillit zgjedhor janë këto:**

- Personi që kontrollon dokumentet e identifikimit personal të votuesve (1)
- Kryetari/zëvendëskryetari që menaxhon me aparatën për identifikim biometrik të votuesve (2)
- Personi që menaxhon me ekstraktet e listës zgjedhore (3)
- Personi që i jep fletëvotimet dhe vë vulën (4)
- Personi përgjegjës për kutinë e votimit (5).

#### VËREJTJE:

me pajisjen për identifikim biometrik të votuesve menaxhojnë ekskluzivisht kryetari i KZ-së dhe zëvendësi i tij. Në rast të mungesës së të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZ-së, me aparatën menaxhon anëtari/zëvendësanëtari i KZ-së nga rradhët e administratës i cili do të autorizohet prej shumicës së anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të KZ-së që janë prezent. Situata e këtillë evidentohet në ditarin për regjistrimin e ngjarjeve.

**Anëtarët tjerë të KZ-së, gjatë ditës, në ç' do dy orë, ndërrohen dhe i zëvendësojnë pozitat e mbetura në këshillin zgjedhor!!!**

Çdo anëtar i Këshillit zgjedhor, përveç obligimit themelor, kryen edhe punë të tjera të domosdoshme për organizimin dhe zbatimin e pandërprerë të zgjedhjeve.

### 6.1.1. Detyrat e kryetarit të KZ-së

NË MUNGESË TË KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR, TË GJITHA AKTIVITETET E PËRMENDURA I KRYEN ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT ZGJEDHOR!

Para fillimit të votimit
<ul style="list-style-type: none"><li>• E plotëson pjesën e Procesverbaleve (Formularët numër 16) të cilët plotësohen para fillimit të votimit (Pjesa I)</li><li>• E shpërndan materialin zgjedhor (të besueshëm dhe jo të besueshëm) anëtarëve të Këshillit zgjedhor</li><li>• E shkruan numrin e vendvotimit në zarfet, thasët dhe materialet e tjera që do të përdoren në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve.</li><li>• Kujdeset (organizon) që vendvotimi të jetë i rregulluar në mënyrë adekuate</li><li>• Kutitë e zbrazëta të votimit ua tregojnë të gjithë personave të pranishëm në vendvotim.</li><li>• E aktivizon pajisjen për identifikimin biometrik të votuesve (PIBV).</li><li>• E printon raportin nga PIBV dhe atë raport e bashkëngjet në ditarin për evidencë të ngjarjeve.</li><li>• Nëse këshilli zgjedhor ditën paraprake e ka zbatuar votimin e personave të sëmurë ose të pafuqishëm, apo të personave të cilët janë në paraburgim shtëpiak, para se ta mbyllë kutinë e votimit:<ul style="list-style-type: none"><li>○ i hap zarfet e ngjitura me fletëvotimet nga këta votues,</li><li>○ pa shikuar për cilin është votuar, i fut ato në kutinë e votimit.</li><li>○ Numrin e këtyre fletëvotimeve e shënon në Procesverbalët (Formulari numër 16), <u>në rubrikën përkatëse.</u></li></ul></li><li>• I mbyll kutitë e votimit me shiritat e sigurisë me numra të vulosur në to dhe ato i vë në mënyrë që do të mund t'i shohin të gjithë personat që janë të autorizuar të jenë të pranishëm në atë vendvotim. Lartësia e vendosjes së kutive të votimit duhet të jetë gjithashtu e përshtatshme që të mund person në karrocë invalidësh vetë t'i fut fletëvotimet brenda.</li><li>• <b>Numrat e shiritave prej plastmase për siguri i shënon në Ditarin për evidencë të ngjarjeve.</b></li></ul>
Gjatë kohës së votimit
<ul style="list-style-type: none"><li>• Përkujdeset për gjitha aktivitetet që do të realizohen në vendvotim në pajtim me procedurat e përcaktuara në Udhëzuesin për edukim.</li><li>• Në procesverbal dhe në Ditarin e ngjarjeve e shënon kohën e hapjes së vendvotimit (Formulari numër 16a), <u>në rubrikën përkatëse</u>, si dhe në Ditarin për evidencën e ngjarjeve.</li><li>• I plotëson procesverbalet (tërësisht dhe saktë)</li><li>• <b>Menaxhon me pajisjen për identifikimin biometrik të votuesve</b></li><li>• Të dhënat nga dalja e votuesve i dërgon në Komisionin Komunal Zgjedhor.</li><li>• Është përgjegjës për <b>mirëmbajtjen e rendit dhe paqes në vendvotim</b>. Në rast të cenimit të rendit dhe paqes, kryetari i KZ-së:<ul style="list-style-type: none"><li>- thërret policinë (me gojë, me shkrim, përmes telefonit, ose në mënyrë tjetër siç përshtatet me situatën)</li><li>- plotëson Formularin në lidhje me nevojën për thirrjen për polici dhe</li><li>- menjëherë e njofton Komisionin Komunal Zgjedhor</li></ul></li><li>• Kur rendi dhe paqa vendosen sërish, përkujdeset dhe sigurohet që policia ta braktisë vendvotimin</li></ul>

- Komunikon me përfaqësuesit e autorizuar, vëzhguesit dhe gazetarët vetëm për INFORMACIONE TEKNIKE RRETH PROCESIT ZGJEDHOR (për shembull, numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin e Listës Zgjedhore, të dhënat për daljen e votuesve nga momenti i dhënies së deklaratës dhe ngj.).  
Për informacione lidhur me pyetjet gjatë votimit dhe procesit zgjedhor, gazetarët udhëzohen në KSHZ.

#### Gjatë mbylljes së vendvotimit

- Në orën 19:00 e mbyllë vendvotimin,
  - Nëse ka votues të cilët presin në radhë, kretari i KZ-së cakton një anëtar i cili do të qëndrojë në fundin e radhës së votuesve që kanë qenë para objektit të votimit.
- E printon raportin nga PIBV-ja.
- Të dhënat nga raporti prej PIBV-së i shënon në rubrikat përkatëse në Procesverbalët (Formulari nr. 16)
- Do ta mbyll kapakun e kutive të votimit
- Do të sigurohet që pas votimit të votuesit të fundit, në vendvotim të pranishëm të jenë vetëm personat të cilët janë të autorizuar për prezencë
- E shënon kohën e mbylljes së vendvotimit në Procesverbal (Formulari 16), në rubrikën përkatëse.
- **Në Ditarin për evidencë të ngjarjeve:**
- shënon kohën e mbylljes së vendvotimit
- shënon emrat e përfaqësuesve të autorizuar të pranishëm dhe të vëzhguesve
- e bashkëngjet raportin e printuar nga PIBV-ja.

#### Gjatë kohës së numërimit të votave

Përmes numërimit të nënshkrimeve dhe gjurmëve në Listën zgjedhore, verifikohet numri i përgjithshëm i votuesve që kanë votuar. Ky numër shënohet në Procesverbalët. **(Formulari numër 16).**

- Pyet përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave, nëse kanë ndonjë vërejtje për procedurën e zgjedhjeve dhe nëse kanë, ato i shënon në Procesverbal **(Formulari numër 16)**, në pjesën e shënimeve për procedurën e votimit.
- Përkujdeset për respektimin e procedurës së përshkruar për përmbledhjen dhe konfirmimin e rezultateve.
- Në Procesverbalët **(Formularët numër 16)** i shënon të dhënat të cilat verifikohen në procedurën për përputhshmërinë e fletëvotimeve (Shih: përputhshmëri e fletëvotimeve.)
- Kontrollon nëse numri i shiritave të plastikës për siguri të numëruar përputhet me numrin me të cilin është mbyllur kutia e votimit dhe që është i shënuar në Ditarin e ngjarjeve.
  - Nëse numrat përputhen, këtë e shënon në Ditar.
  - Nëse ato nuk përputhen, atë e shënon në Procesverbalet (Formularët numër 16) në pjesën VI – Vërejtje dhe për këtë e njofton Komisionin komunal zgjedhor DHE VAZHDON ME PROCEDURËN PËR NUMËRIMIN E VOTAVE.
- E HAP KUTINË E VOTIMIT. Në rastin kur mbahen dy lloje zgjedhjesh në një ditë, i HAP kutitë e votimit njëerën pas tjetrës.
- (Me short përcakton njërin nga anëtarët e Këshillit zgjedhor i cili do t'i nxjerr fletëvotimet nga kutia e votimit, do t'i hap dhe do t'ia japë kryetarit.)
- Kryetari i KZ-së, secilin fletëvotim ua tregon personave që janë të pranishëm.
- Çdo fletëvotim e vendos në grumbull të posaçëm që pastaj të numërohen votat.
- I numëron votat për çdo kandidat ose listë.
- E plotëson pjesën V nga Procesverbalet **(Formularët nr. 16)** me rezultatet e fituara nga numërimi.

#### Gjatë paketimit të materialit

Përkujdeset për radhitjen e përkatëse të materialit të plotë në pakot përkatëse. I përmbahet teknikës së paketimit të materialit ashtu siç është përshkruar në pjesën e këtij udhëzuesi “Paketimi i materialit zgjedhor” dhe i përmbahet **Udhëzimit dhe Udhëzuesit për mënyrën e përdorimit dhe pranim-dorëzimit të pajisjeve për identifikim biometrik të votuesve.**

## **6.2. PRANIMI DHE SIGURIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR**

- ✓ Komisioni komunal zgjedhor e njofton Këshillin Zgjedhor për kohën e saktë të dorëzimit të materialit zgjedhor
- ✓ Për pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor përpilohet procesverbal. (Formulari numër 14).
- ✓ Gjatë pranim-dorëzimit të materialit zgjedhor doemos të pranishëm janë kryetari dhe anëtarët e KZ-së.
- ✓ Menjëherë pas pranimit, anëtarët e Këshillit Zgjedhor duhet në mënyrë të detajuar ta kontrollojnë numrin e fletëvotimeve që i janë dorëzuar!!!

**NË MUNGESË TË KRYETARIT TË KËSHILLIT ZGJEDHOR, TË GJITHA AKTIVITETET E PËRMENDURA I REALIZON NËNKRYETARI I KËSHILLIT ZGJEDHOR!**



## PROCEDURA (FORMULA) PËR NUMËRIMIN E FLETËVOTIMEVE QË JANË DORËZUAR:

- Fletëvotimet ju dorëzohen në bllok (koçan).
- Çdo bllok (koçan) dhe fletëvotimet, kanë sfond të ndryshëm, varësisht nga ajo se a janë për zgjedhje të Presidentit të Republikës apo për zgjedhjet për deputetë në Kuvend
- Çdo fletëvotim ka numrin e vet serik.
- Numri serik është i shtypur në pjesën e fletëvotimit i cili ngel në bllok (koçan) (shih foton 1!).
- Më 24 prill do t'ju dorëzohet një koçan me fletëvotime. Më 8 maj do t'u dorëzohen dy koçanë me fletëvotime: njëri koçan për zgjedhjet për President dhe tjetri koçan për zgjedhjet për deputetë në Kuvend.
- **KONTROLLONI BLOQET ME KUJDES, NJË NGA NJË!**
- Искористете ги сериските броеви за да проверите колку гласачките ливчиња сте добиле во кочанот
- Nga numri serik i shënuar në fletëvotimin e fundit minusohet numri serik i shënuar në fletëvotimin e parë dhe dallimi rritet për +1 sipas formulës në vijim:

### SHEMBULL:

numri serik i fletëvotimit të fundit	-	numri serik i fletëvotimit të parë	+ 1 =	numri i përgjithshëm i fletëvotimeve
2.035	-	1.501	+ 1 =	535

- Numri i fletëvotimeve duhet të përputhet (të jetë i njëjtë) me numrin e zgjedhësve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për vendvotimin përkatës.

**Shembull:** Nëse në listën zgjedhore ka 535 zgjedhës, atëherë duhet të fitoni rezultatin për 535 fletëvotime.



Foto 1

Të drejtë për të marrë pjesë në pranim-dorëzimin e materialit zgjedhor kanë:

1. përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave (ata kanë të drejtë të japin vërejtje që do të evidentohen në procesverbal (Formulari numër 14)
2. vëzhguesit e autorizuar
3. gazetarët

- ✓ Pjesëtarët e policisë e sigurojnë pranimin e materialit, vendvotimin, Këshillin Zgjedhor dhe të gjithë personat e pranishëm në pranimin e materialit zgjedhor
- ✓ Pas përfundimit të pranimin të materialeve, hapësira mbyllet deri në ditën e votimit

LLOJE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE

MATERIAL ZGJEDHOR KONFIDENCIAL	MATERIAL ZGJEDHOR JOKONFIDENCIAL
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pajisja teknike (Pajisje për identifikim biometrik të votuesve (PIBV SVT 5008 me MRZ skener) i cili përmban kuti mbrojtëse, printer termal me shirit prej letre, shtesa të tjera - kablo dhe kartela të veçanta për aktivizim të pajisjes (foto 8);</li> <li>2. Bllok me fletëvotime sipas ekstraktit nga Lista zgjedhore (koçan);</li> <li>3. Ekstrakt i nënshkruar nga lista zgjedhore për vendvotim (foto 2);</li> <li>4. Ekstrakt i veçantë nga Lista zgjedhore për qytetarët të cilët janë me punë ose qëndrim të përkohshëm jashtë vendit;</li> <li>5. Ditari për evidentimin e ngjarjeve në vendvotim;</li> <li>6. Vaj UV (vaj ultra - violet) në formë të spërkatësit për shënim të votuesve të cilët kanë votuar (foto 4);</li> <li>7. Llambë UV për kontrollim (foto 7);</li> <li>8. Jastëk grafiti (foto 3);</li> <li>9. Vula me numrin e vendvotimit</li> <li>10. Formularët e procesverbaleve: <ul style="list-style-type: none"> <li>- për dorëzim të materialit zgjedhor nga KKZ në KZ (Formulari numër 14);</li> <li>- për dorëzim/kthim të PIBV nga KKZ në KZ (Formulari numër 14a);</li> <li>- për gjendjen e konstatuar të hapësirës për votim, të materialit zgjedhor, kutive për votim dhe funksionalitetit të PIBV nga Këshilli Zgjedhor, (Formulari numër 15);</li> <li>- për votim, përmbledhje dhe vërtetim të rezultatit nga vendvotimi, (Formulari numër 16);</li> <li>- Procesverbal i veçantë për votim sipas listës së</li> </ul> </li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Paravanët e votimit;</li> <li>2. Lista e kandidatëve (poster informativ);</li> <li>3. Kutitë e votimit (foto 5);</li> <li>4. Shirita sigurues plastike të numëruara për mbylljen e materialit të besueshëm zgjedhor (foto 6);</li> <li>5. Zarfe për paketim, për secilin fletëvotim të vlefshëm për secilën listë të kandidatëve veçmas;</li> <li>6. Zarf për fletëvotimet e pavlefshme;</li> <li>7. Zarf i bardh për të gjitha fletëvotimet e përdorura;</li> <li>8. Zarf i bardh për të gjitha fletëvotimet e papërdorura dhe koçanin e fletëvotimeve të papërdorura;</li> <li>9. Zarf për ekstraktet nga lista zgjedhore;</li> <li>10. Zarf për Ditarin për evidencë dhe raportet e printuara nga PIBV;</li> <li>11. Thasë plastike: të mëdhenj, të tejdukshëm, të shënuar me etiketën për transport të materialit të besueshëm;</li> <li>12. Shabllon me Alfabetin e Brajtit</li> <li>13. Vizore;</li> <li>14. Bateri përkatëse për çdo llambë UV</li> <li>15. Material tjetër i jobsueshëm: ku bëjnë pjesë <ul style="list-style-type: none"> <li>- stilolapsa;</li> <li>- marker i thjeshtë;</li> <li>- vizore;</li> <li>- bexha për anëtarët e KZ-së;</li> <li>- udhëzim shumëgjuhësh për votim;</li> <li>- material tjetër i nevojshëm për votim.</li> </ul> </li> </ol>

kandidatit për zgjedhës të cilët janë duke vuajtur dënim me burg ose janë në paraburgim në Ent/Institucion ndëshkimorkorrigjues (Formulari numër 18);

- Procesverbal i veçantë nga votimi në listën e kandidatëve për zgjedhës të cilët votojnë në Ent të veçantë për përkujdesje jashtëfamiljare (Formulari nr. 31);

- Procesverbal i veçantë nga votimi në listën e kandidatëve për zgjedhësit me status të personave të zhvendosur brenda shtetit (formulari nr. 19);

- për dorëzim të procesverbalit për votim dhe të materialit zgjedhor tjetër nga KZ në Këshill të Veçantë Zgjedhor (Formular nr. 20);

- për dorëzim të procesverbalit për votim dhe të materialit zgjedhor tjetër nga KKZ në KSHZ (Formulari nr. 22);

- Formular për vërtetimin e nevojës për thirrje të policisë;

- Formular për pamundësinë për realizimin e së drejtës zgjedhore sipas nenit 107 nga Kodi Zgjedhor;

11. Dekoder për kryetarin e KKZ-së, dërgohet nga KSHZ-ja;

12. Kodi për regjistrimin e rezultateve në softuerin për rezultate për kryetarin e KKZ-së, dërgohet nga KSHZ-ja;





Foto 2



Foto 3



Foto 4



Foto 5




Foto 6



Foto 7



Foto 8

SHËNIM:

Mënyra e pranim-dorëzimit të PIBV-ve dhe kartelave, si dhe ruajtja dhe menaxhimi me to është e rregulluar në kreun 7.5 të këtij Udhëzuesi.

### 6.3. RREGULLIMI I VENDVOTIMI

NDALIM I PROPAGANDËS:

- ✓ Largoni **të gjitha** materialet propaganduese (**pano, afishe etj**).
  - **nga hapësira ku është vendosur vendvotimi**
  - **jashtë nga rrethi i afërt në radius prej 100 metrave nga vendvotimi**

#### INFORMIMI I VOTUESVE:

**Në vend të dukshëm ngjitni materialet informative për të gjithë votuesit që më lehtë të orientohen në hapësirë:**

- ✓ Ngjitni **shenjën me** numrin e vendvotimit në hyrjen e hapësirës **ku do të votohet (nëse në një objekt ka dy ose më tepër vendvotime numri rendor i tyre shënohet edhe në çdo hapësirë që është përcaktuar për votim)**
- ✓ Vendosni listën e kandidatëve **në vend të dukshëm për votuesit**
- ✓ Vendosni përshkrimin e vendvotimit **(me adresat)**
- ✓ **Vendosni ilustrimet me fotografi për hapat e procedurës për votim në vendet e duhura**
- ✓ Udhëzimin për votim **vendoseni në vend ku do ju mundësojë të gjithë votuesve të sapoardhur ta vërejnë dhe ta lexojnë**
- ✓ Ditën e zgjedhjeve kur zbatohen dy procese zgjedhore, **shenjoni** secilën kuti të votimit me shenjën përkatëse
  - **për President të shtetit,**
  - **për deputetë në Kuvend.**

#### ORGANIZIMI I VENDVOTIMIT

- ✓ Sistemoni **tavolinat ose bankat në mënyrë që të sigurohet votim i papenguar**
- ✓ Sigurohuni që të ketë distancë të mjaftueshme që personat me mjete ndihmëse të mund të lëvizin brenda në hapësirë!

**PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR DHE VËZHGUESIT SIGURONI POZITË PREJ KU DO TË KENË SHIKUESHMËRI TË PLOTË TË TËRË PROCESIT.**


**Për ata është e LEJUAR:**

- në afërsi të drejtpërdrejtë të vëzhgojnë vërtetimin e identitetit të votuesve,
- pa pengesa të vëzhgojnë procedurën e votimit,
  - pa e cenuar fshehtësinë e votimit – vetëm të mos kenë qasje në hapësirën pas paravanëve të votimit.

- ✓ **Vendosni paravanët e votimit që të sigurohet fshehtësia dhe askush të mos mund të shikojë se si zgjedhësi e ka plotësuar fletëvotimin**
- ✓ **Detyrimisht vendoseni paravanin për persona me karrocë invalide dhe sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme që personi me karrocë të hyjë prapa paravanit!**

1. Утврдување на идентитет со л.к. или пасош
2. Биометриска идентификација на гласачот
3. Потпишување во извод од ИС
4. Издавање гласачки ливчиња

6. Овластени претставници и акредитирани набљудувачи



6. Уредено гласачко место (стрелките го означуваат движењето на гласачите)

## 6.4. ZGJEDHËSIT QË VOTOJNË DITËN PARA ZGJEDHJEVE

Ekzistojnë KATËR grupe të zgjedhësve të cilët votojnë një ditë para ditës së zgjedhjeve:

- 1) personat e sëmurë ose të pafuqishëm dhe ata që janë në paraburgim shtëpiak,
- 2) personat që janë duke vuajtur dënim me burg ose janë në paraburgim,
- 3) personat e zhvendosur brenda vendit dhe
- 4) personat, të cilët gjatë kohës së zgjedhjeve janë nën kujdesin e institucioneve të kujdesit jashtëfamiljar.

### 6.4.1. Votimi i personave të pafuqishëm ose të sëmurë dhe i personave në burg shtëpiak

<b>CILËT PERSONA MUND TË VOTOJNË NJË DITË PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE NË ADRESË TË PARAQITUR?</b>	<p>KOMISIONI KOMUNAL ZGJEDHOR PËRPILON <u>LISTË TË PERSONAVE TË SËMURË OSE TË PAFUQISHËM DHE LISTË TË PERSONAVE QË GJENDEN NË PARABURGIM SHTËPIAK</u> TË CILËT DO TË VOTOJNË NË SHTËPITË E TYRE.</p> <p>KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE KËTO LISTA IA DORËZON KËSHILLIT ZGJEDHOR. <u>VETËM PERSONAT QË GJENDEN NË KËTO LISTA MUND TË VOTOJNË NJË DITË PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE!</u></p>
<b>KUSH E ZBATON VOTIMIN PËR PERSONAT E PAFUQISHËM DHE TË SËMURË?</b>	<p>Votimin për këto persona e zbaton Këshilli Zgjedhor në të cilin personi është i regjistruar në ekstraktet e Listës zgjedhore për vendvotimin përkatës.</p> <p>Votimi zbatohet në adresën të cilën e ka paraqitur votuesi dhe mund të jetë e ndryshe nga ajo në dokumentin e identifikimit. Adresa e votimit duhet patjetër të gjendet në territorin e komunës përkatëse.</p>
<b>ÇKA DUHET TË SJELL ME VETE VOTUESIT PËR TA REALIZUAR VOTIMIN E PERSONAVE TË PAFUQISHËM OSE TË SËMURË?</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1) Ekstrakt të Listës zgjedhore,</li><li>2) Llambë UV,</li><li>3) UV spërkatës,</li><li>4) vulë me numrin e vendvotimit,</li><li>5) fletëvotime për zgjedhje të Presidentit të Republikës (në përputhje me numrin e votuesve që ka në listën e ndarë nga Komisioni komunal zgjedhor),</li><li>6) fletëvotime për zgjedhje të deputetëve në Kuvendin (në përputhje me numrin e votuesve që ka në listën e ndarë nga Komisioni komunal zgjedhor),</li><li>7) zarfe të vogla të zbrazëta (për çdo fletëvotim të grisur nga një zarf),</li><li>8) një nga kutitë e pranuar të votimit (E VULOSUR ME SHIRITA SIGURUES!),</li><li>9) jastëk për gjurmët e gishtave (në rast se ndonjë prej votuesve – të sëmurë ose të pafuqishëm është analfabet).</li><li>10) kufizues dhe</li><li>11) Shabllon me Alfabetin e Brajit</li></ol>

**CILA ËSHTË PROCEDURA  
PËR VOTIM TË  
PERSONIT TË  
PAFUQISHËM OSE TË  
SËMURË?**

**SHËNIM:** Para se të grisen fletëvotimet, këshilli zgjedhor kontrollon nëse votuesit, të cilët janë të evidentuar në listën e përgatitur nga KKZ-ja, janë në ekstraktin e Listës Zgjedhore për atë vendvotim. Pastaj, këshilli zgjedhor i gris **fletëvotimet nga blloku. Me vete merr aq fletëvotime sa është numri i votuesve në listë!**

Për realizimin e votimit të kësaj kategorie të personave, nuk përdoret pajisje teknike për identifikim biometrik të votuesve, por vetëm UV llambë dhe UV sprej.

<b>SI KONTROLLOHET FUNKSIONALITETI I PIBV-SË?</b>	Kontrollimi i funksionalitetit të PIBV-së kryhet në atë mënyrë që i njëjti ndizet, personi që menaxhon PIBV-në të jetë i identifikuar, të zgjidhet një gjuhë për funksionimin e PIBV-së dhe të printohet raport me gjendjen aktuale të të dhënave në PIBV.
<b>ÇFARË INFORMACION DUHET TË SHPALL PIBV NË EKTRAN?</b>	PIBV-ja shfaq informacionet si vijojnë në ekran: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjedhjet (titulli) dhe data e zgjedhjeve</li> <li>- Koha aktuale</li> <li>- Komuna</li> <li>- Numri i vendvotimit</li> <li>- Totali i votuesve të regjistruar</li> <li>- Totali i votuesve që votuan (konfirmimi është zero nëse diçka është regjistruar në pajisje)</li> <li>- Totali i votuesve që votuan dhe u verifikuan me sukses me gjurmë gishtash (verifikimi është zero siç është regjistruar në pajisje)</li> <li>- Shpërndarja gjinore e votuesve që votuan (p.sh. zero burra dhe zero gra).</li> </ul>
<b>Ç'NDODH ME ATO INFORMACIONE?</b>	PIBV printon raport të veçantë për këtë informacion.
<b>ÇFARË DUHET TË BËJË KZ-JA ME ATË RAPORT?</b>	Të dhënat nga procesverbali i shtypur duhet të shënohen në procesverbal (formulari nr. 15) për gjendjen e përcaktuar të dhomës

	së votimit, materialin zgjedhor dhe kutitë e votimit nga Këshilli Zgjedhor për vendvotimin dhe procesverbali i printuar i bashkëngjitet ditarit për evidencën e ngjarjeve.
<b>A SIGURON PIBV-JA TË DHËNAT PËR PJESËMARRJEN E VOTUESVE?</b>	PIBV ofron të dhëna për pjesëmarrjen e votuesve gjatë votimit, në një interval kohor jo më shumë se dy orë.

### 7.5.3. Identifikimi me PIBV

<p><b>KUR AKTIVIZOHET PIBV PËR IDENTIFIKIMIN E VOTUESVE? SI DUHET TË RRJEDHË PROCEDURA E IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE?</b></p>	<p><b>PIBV AKTIVIZOHET PËR IDENTIFIKIMIN E VOTUESVE ME FILLIMIN E VOTIMIT NË VENDVOTIM.</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identitetin personal zgjedhësi e dëshmon me letërnjoftim të vlefshëm ose dokument udhëtimi valid përkatësisht me letërnjoftim vlefshmëria e të cilit ka skaduar në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e skadimit realizimit të tyre dhe dokument udhëtimi afati i vlefshmërisë së të cilit skadon pas datës 31 korrik 2020, vlefshmëria e të cilit vazhdohet deri më 31 dhjetor 2021 dhe me gjurmë të gishtit.</li> <li>2. Votuesi hyn në vendvotim dhe tregon dokumentin valid para anëtarit të Këshillit Zgjedhor i cili e menaxhon PIBV-në, ndërsa votuesi që nuk ka dokument personal nuk do t'i lejohet të identifikohet me gjurmë të gishtave në PIBV dhe nuk do t'i lejohet të votojë.</li> <li>3. Anëtarit i Këshillit Zgjedhor e krahason fotografinë në nga letërnjoftimi ose dokumenti i udhëtimit me fytyrën e votuesit, ndërkaq nëse konstatohet që fytyra nuk është e njëjtë, nuk i lejon të identifikohet me gjurmë të gishtit në PIBV dhe nuk do t'i lejohet të votojë.</li> <li>4. Këshilli Zgjedhor e vërteton identitetin dhe kontrollon nëse votuesi nuk ka votuar paraprakisht nëpërmjet të dhënave nga letërnjoftimi valid ose dokumenti valid i udhëtimit dhe me lexim të gjurmëve të gishtit që duhet të përputhet me gjurmët e gishtit të votuesit në listën elektronike zgjedhore për vendvotimin përkatës në pajisjen teknike.</li> <li>5. Këshilli Zgjedhor e vërteton identitetin dhe kontrollon nëse votuesi nuk ka votuar paraprakisht në mënyrë që nga votuesi merr gjurmët nga gishti tregues i dorës së djathtë..</li> <li>6. Nëse votuesi nuk ka gisht tregues të djathtë, gjurmë merret nga treguesi i dorës së majtë.</li> <li>7. Nëse votuesit i mungojnë këta dy gishta, gjurmë merret nga gishti i radhës në dorën e djathtë dhe këtë e evidenton në ditarin për evidentim të ngjarjeve.</li> <li>8. Nëse votuesi nuk i ka dy duart, Këshilli Zgjedhor do ta konstatojë gjendjen me evidentim në ditarin për evidentim të ngjarjeve dhe votuesi evidentohet në pajisjen teknike me kërkim nëpërmjet numrit të tij të vetëm amë (NVAQ).</li> </ol>
<b>SI RRJEDHË IDENTIFIKIM I VOTUESIT ME PIBV?</b>	PIBV e lexon gjurmën e gishtit dhe kërkon të gjejë përputhje me gjurmët e gishtit që janë në listën zgjedhore elektronike për të gjithë

<p><b>KUR KONSIDEROHET IDENTIFIKIMI SI I RREGULLT?</b></p>	<p>votuesit e regjistruar në atë vendvotim, derisa nuk gjen përputhje. Nëse softueri sugjeron që cilësia e gjurmës është e keqe ose e dobët, softueri i PIBV-së këtë e trajton si skanim të gabuar të gjurmës dhe kërkon të përsëritet procesi i skanimit të gishtit të njëjtë. Nëse nuk gjendet përputhje, votuesit duhet t'i skanohet treguesi i dorës së majtë dhe procesi përsëritet. Nëse votuesi nuk ka tregues në dorën e majtë, e jep gjurmën sipas radhës përkatëse dhe këtë Këshilli Zgjedhor e evidenton në ditarin për evidentim të ngjarjeve.</p> <p>Kur këshilli zgjedhor do të konstatojë që zgjedhësi i cili është i regjistruar në listën zgjedhor e ka vërtetuar identitetin e tij dhe ka konstatuar që zgjedhësi nuk ka votuar paraprakisht dhe gjurmët e gishtit përputhen me gjurmët në listën zgjedhore elektronike, në monitorin e pajisjes do të shfaqen të dhënat e atij zgjedhësi nga lista zgjedhore. Nëse votuesi paraprakisht nuk ka votuar, informatat paraqiten me ngjyrë të gjelbër.</p> <p>Anëtari i Këshillit Zgjedhor e vërteton identifikimin dhe votuesi është i shënuar në sistem se ka votuar.</p>
<p><b>ÇFARË NËSE PIBV NUK MUND TË GJËJË PËRPUTHJE TË GJURMËS SË GISHTAVE?</b></p>	<p>Nëse PIBV nuk mund të gjejë përputhje të gjurmëve të gishtit me gjurmët e gishtit të votuesit në listën zgjedhore elektronike, PIBV sinjalizon me ngjyrë të verdhë. Në atë rast, Këshilli Zgjedhor fillon me vërtetimin e identitetit personal të votuesit nëpërmjet letërnjoftimit të vlefshëm ose dokumentit për udhëtim dhe kontrollon nëse votuesi është i regjistruar dhe nëse është i nënshkruar në listën zgjedhore.</p> <p>Këshilli Zgjedhor nëse konstaton që votuesi është në ekstraktin e shtypur të Listës zgjedhore dhe nuk ka votuar paraprakisht, votuesi evidentohet në PIBV nëpërmjet leximit të dokumentit personal në lexuesin MRZ ose nëpërmjet shënimit të numrit të tij të vetëm amë (NVAQ).</p> <p>Nëse i vërtetohet identiteti i përmendura nëpërmjet procedurës nga paragrafët paraprak në këtë nen, votuesi jep gjurmë të gishtit në PIBV dhe Këshilli Zgjedhor e konstaton gjendjen me evidentim në ditarin për evidentim të ngjarjeve.</p>
<p><b>ÇFARË NËSE VOTUESI ËSHTË SHËNUAR NË SISTEM SIKUR KA VOTUAR?</b></p>	<p>Nëse votuesi është i shënuar në sistem se ka votuar, sistemi i shfaq informatat me të kuqe dhe sinjalizon me alarm dhe të njëjtit nuk do t'i lejohet të votojë.</p>
<p><b>SI RRJEDHË PROCEDURA PAS PËRCAKTIMIT TË IDENTITETIT TË VOTUESIT?</b></p>	<p>Pas konfirmimit të identitetit të votuesit, Këshilli Zgjedhor rrethon numrin rendor të tij në ekstraktin nga lista zgjedhore dhe votuesi vendos nënshkrimin e tij dhe nëse është analfabet, vë gjurmën e gishtit tregues të djathtë.</p> <p>Nëse votuesi është analfabet dhe nuk ka gishtin tregues të djathtë, nga gishti tregues i dorës së majtë merret shenja e gishtit, e nëse nuk ka gishtin tregues të majtë, nuk i vendoset gjurmë gishti dhe e njëjta shënohet në ditar për evidencën e ngjarjeve.</p> <p>Pas identifikimit dhe nënshkrimit në listën zgjedhore, votuesi merr fletëvotimin.</p>

**8.5.1. Procedura në rast se PIBV është i parregullt ose i papërdorshëm**

**SI VEPRON KZ-JA NËSE PIBV ËSHTË TEKNIKISHT I PARREGULLT DHE I PAPËRDORSHËM?**

**NË RAST SE PIBV ËSHTË TEKNIKISHT I PARREGULLT DHE I PAPËRDORSHËM, KËSHILLI ZGJEDHOR NJOFTON MENJËHERË ME TELEFON KOMISIONIN KOMUNAL ZGJEDHOR ME QËLLIM QË KOMISIONI ZGJEDHOR KOMUNAL TË BËJË ZËVENDËSIM TË PIBV-SË.**

**SI VEPRON KKZ-JA PAS NJOFTIMIT NGA KZ-JA?**

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve menjëherë dërgon në vendvotim një person teknik të autorizuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i cili bart PIBV të ri rezervë dhe konstaton gjendjen në vend, dhe nëse konstaton se PIBV është teknikisht i parregullt dhe i papërdorshëm, njofton Komisioni Komunal të Zgjedhjeve përmes telefonit dhe e instalon PIBV-në e re rezervë dhe njëkohësisht i transferon të gjitha të dhënat në PIBV-në e re.

**ÇFARË NËSE PIBV-JA ËSHTË I PAPËRDORSHËM DHE NUK MUND TË ZËVENDËSOHET?**

Për transportin dhe dorëzimin e pajisjeve, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve duhet të njoftojë policinë.

Në rast se PIBV-ja është e papërdorshme dhe nuk mund të zëvendësohet, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në bazë të vërtetimit nga eksperti teknik i punësuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në mënyrë elektronike menjëherë i paraqet kërkesë me shkrim Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili vendos nëse procedura e votimit do të vazhdojë në përputhje me nenin 108 të Kodit Zgjedhor.

## 7.5.5. Përfundimi i votimit

**SI VAZHON KZ-JA PAS PËRFUNDIMIT TË VOTIMIT?**

**PAS PËRFUNDIMIT TË VOTIMIT NË VENDVOTIM (PASI KA VOTUAR VOTUESI I FUNDIT), KRYETARI OSE ZËVENDËSKRYETARI I KZ-SË DEAKTIVIZON PIBV-NË PËR IDENTIFIKIME TË MËTEJSHME TË VOTUESVE, PASI NUK DO TË MUND TË AKTIVIZOHET PËRSËRI.**

**ÇFARË TË DHËNASH DUHET TË SHPALLË PIBV-JA?**

PIBV duhet të shfaqë automatikisht ekran që përmban informacionin e mëposhtëm:

- Zgjedhjet (titulli) dhe data e zgjedhjeve

- Koha aktuale

- Komuna

- Numri i vendvotimit

- Totali i votuesve të regjistruar

- Numri total i votuesve që votuan dhe u verifikuan me gjurmë gishtash (e pasqyruar në numra dhe përqindje të numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar për atë vendvotim)

- Gjithsej votuesi që nuk mund të identifikoheshin nga PIBV përmes gjurmës së gishtit, por u identifikuan në PIBV duke skanuar dokumentin personal me skanerin MP3 ose duke futur në mënyrë manuale në NVAQ të votuesit dhe gjurmët e gishtave të cilëve janë mbledhur nga PIBV (e pasqyruar në numër dhe përqindja e numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar për atë vendvotim)

- Numri i burrave dhe grave që votuan (e pasqyruar si numër dhe përqindje e të gjithë votuesve që votuan për atë vendvotim)

Për gjendjen, pajisja printon raport me shkrim që do të jetë pjesë përbërëse të ditarit për evidencën e ngjarjeve.

**ÇFARË DUHET KZ-JA TË BËJË ME ATO TË DHËNA?**

Të dhënat nga raporti i shtypur duhet të shënohen në procesverbal (formulari nr. 16), dhe raporti i shtypur i bashkëngjitet ditarit për evidencën e ngjarjeve.





## 8.6. KUNDËRSHTIMET NGA VOTUESIT

Në përputhje me Udhëzimin e veçantë për procedurën e ushtrimit të së drejtës zgjedhore për zgjedhësin që në ditën e votimit plotëson kushtet ligjore për të qenë i regjistruar në Listën zgjedhore, kundërshtim deri në komisionin komunal zgjedhor mund të parashtrijë çdo zgjedhës i cili nuk është i regjistruar, por i plotëson kushtet për të qenë i regjistruar në listen zgjedhore në ditën e votimit.

Në këtë kuptim, **komisioni zgjedhor, me kërkesë të votuesit, do të plotësojë Formularë për pamundësinë e ushtrimit të së drejtës së votës**, të miratuar nga KSHZ-ja, **në dy kopje**, në të cilën do të shënojë dhe arsyetojë arsyet dhe një kopje do t'i japë zgjedhësit.

Pas mbërritjes në vendvotim, votuesi për të cilin KKZ-ja ose Gjykata Administrative ka marrë një vendim përfundimtar (Aktvendim) me të cilin ka përcaktuar se votuesi plotëson kushtet ligjore për t'u regjistruar në listën zgjedhore në ditën e votimit, regjistrohet në listën zgjedhore nga KZ-ja, nëse votimi është në vazhdim.

KZ-ja do ta regjistrojë atë në listën zgjedhore dhe do ta lejojë të votojë vetëm personin që i dorëzon vendim (Aktvendimin) përfundimtar për regjistrim në listën zgjedhore.

Identiteti i këtyre personave vërtetohet duke lënë gjurmë gishti me një bllok grafiti në formularin e posaçëm të caktuar. KZ do ta regjistrojë votuesin në atë formular dhe do t'ia jep fletëvotimin, pas së cilës ai do të vazhdojë me procedurën e votimit.

Vnedimi përfundimtar (Aktvendimi) në origjinal i bashkangjitet listës zgjedhore.

Për zgjedhësit që në këtë mënyrë janë regjistruar në listën zgjedhore për rrethin e parë të votimit, për rrethin e dytë është e nevojshme ta dorëzojnë përsëri vendimin përfundimtar (Aktvendimin) në vendvotim.

KZ-ja u jep këtyre votuesve fletëvotim nga blloku i vendvotimit. Nëse të gjitha fletëvotimet janë përdorur në vendvotim, KZ do të sigurojë një fletëvotim nga vendvotimi më i afërt dhe ngjarja do të regjistrohet në Ditarët e të dy vendeve.

### VOTIMI I ZGJEDHËSVE QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË

**KUSH MUND TË VOTOJË ME NDIHMËN E PERSONIT TJETËR?**

**ZGJEDHËSI I CILI KA MANGËSI FIZIKE OSE ËSHTË ANALFABET DHE PËR KËTË ARSYE NUK MUND TË VOTOJË NË MËNYRËN E PËRCAKTUR ME KODIN ZGJEDHOR, KA TË DREJTË ME VETE TË MERR PERSON I CILI DO TI NDIHMOJË GJATË VOTIMIT.**

**ÇKA NËSE ZGJEDHËSI NUK KA MARRË ME VETE PERSON QË DO TI NDIHMONTE?**

KZ do të përcaktojë person nga radhët e votuesve prezent në vendvotim. Ky person në asnjë rast nuk duhet të jetë nga radhët e Këshillit zgjedhor, përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave ose vëzhguesve

**A MUNDET PERSON I NJEJTË TU NDIHMOJË TË GJITHË ZGJEDHËSVE QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË?**

JO. Një person i njejtë mund tu ndihmojë vetëm dy zgjedhësve që kanë nevojë për ndihmë!

### SI VOTON ZGJEDHËSI QË KA NEVOJË PËR NDIHMË?

- Para se të votojë, Këshilli zgjedhor do ti bëhet me dije personit që do të jep ndihmë se me ndihmën e tij nuk guxon të ndikojë në vendimin e zgjedhësit.
- Zgjedhësi dhe personi që ndihmon bashkarisht drejtohen pas paravanit për votim. (Votimi edhe në këtë rast detyrimisht bëhet pas paravanit).
- Personi që do të ndihmojë i lexon të gjitha emrat e parashtruesve të listave dhe e pyet votuesin për cilën listë dëshiron të votojë dhe i tregon votuesit numrin rendor para listës së kandidatëve për të cilën votuesi dëshiron të votojë.
- Votuesi personalisht e rrethon numrin rendor/plotëson fletëvotimin!
- Personi i cili ndihmon e plotëson fletëvotimin në vend të votuesit vetëm në rast kur votuesi është i verbër ose ka mangësi fizike dhe për këto arsye nuk mund ta plotësojë fletëvotimin, VETËM nëse nuk shfrytëzon Shabllon me Alfabetin e Braevit.
- Votuesi personalisht e hedh fletëvotimin në kuti!
- Vetëm nëse votuesi ka mangësi fizike për të cilën nuk mund ta hedh fletëvotimin, atëherë personi që ndihmon e hedh fletëvotimin në kuti.


### KU EVIDENTOHET VOTIMI DUKE PËRDORUR NDIHMËN?

Mënyrën e tillë të votimit, Këshilli zgjedhor e evidenton:

- në Procesverbalin (Formulari numër 16), ku evidentohet numri i votuesve që kanë kërkuar ndihmë gjatë votimit, dhe
- Në Ditarin për evidencën e ngjarjeve, me çrast në Ditar evidentohen të dhënat nga letërnjoftimi i personit që ndihmon dhe në vërejtjen nënshkruhen të gjithë anëtarët e KZ.

## 8.7. MBYLLJA E VENDVOTIMIT

- Vendvotimi mbyllet në ora 19:00.
- Zgjedhësit të cilët në ora 19:00 janë hasur në objektin ku votohet, Këshilli zgjedhor ua mundëson të votojnë.
- Në ora 19:00 një anëtar i Këshillit zgjedhor do të qëndrojë në fund të rradhës me zgjedhësit e hasur në objekt. Njëherit nuk lejon që votues të tjerë të vijnë për të votuar pas orës 19:00.
- Kur edhe zgjedhësi i fundit nga radha do të votojë, në vendvotim mund të mbesin vetëm personat e autorizuar.



Personat e autorizuar të cilët mund të jenë prezent vendvotim pas mbylljes së tyre :

- Anëtarët e këshillit zgjedhor
- Përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave
- Vëzhguesit e akredituar
- Kryetari, anëtarët dhe zëvendësit e tyre të Komidionit komunal të zgjedhjeve, dhe
- Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.


- Kur edhe votuesi i fundit do ta lëshojë vendvotimin, kryetari i KZ-së:
  - Do ta printojë raportin nga PIBV (të dhënat nga raporti shënohen procesverbalin numër 16 në rubrikat përkatëse)
  - Do ta deaktivizojë PIBV-në dhe më pas nuk mund të aktivizohet sërish,
  - Do ta mbyllë hapjen në kutinë e votimit,
  - Në Ditarin për evidencë të ngjarjeve do ta shënojë kohën e përfundimit të votimit, si dhe emrat e personave të autorizuar të pranishëm në vendvotim,
  - Në Procesverbalet numër 16, në rubrikën përkatëse, do ta shënojë kohëne e përfundimit të votimit,
  - në Ditarin për evidencën e ngjarjeve i shënon numrat e shiritave sigurues plastikë me të cilat janë

- ➔ do ti informojë përfaqësuesit e autorizuar të pranishëm se nëse e lëshojnë vendvotimin pasi që të fillojë numërimi i fletëvotimeve, nuk do të mund të kthehen përsëri në vendvotim.

## 8.8. NDËRPRERJA E VOTIMIT

KZ mund ta ndërpresë votimin në këto raste:

- ✓ Nëse prishet rendi në vendvotim, derisa nuk rivendoset përsëri
- ✓ Në rast të fatkeqesive të motit dhe rrethanave të tjera të jashtëzakonshme
- ✓ Nëse qasjen në vendvotim nuk e siguron policia ndërsa për atë ka nevojë
- ✓ Nëse policia është thirrur ndërsa nuk i është përgjigjur thirrjes
- ✓ **Në rast të ndonjë problemi teknik ose mosfunksionim të pajisjes teknike për identifikim biometrik të votuesve (në rast të tillë menjëherë kontaktohet KKZ)**
- ✓ Në çdo rast, nëse ka pasur ndërprerje të votimit, **arsyet e ndërprerjes evidentohen në Procesverbal** (Formularët numër 16), në rubrikën përkatëse.



## 8.9. PËRMBLEDHJA DHE VËRTETIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT

Më 8 maj, kur njëkohësisht do të zhvillohen Zgjedhjet Parlamentare dhe rrethi i dytë nga Zgjedhjet Presidenciale, Këshilli zgjedhor i përmbledh rezultatet **sipas kësaj rradhitje:**

- 1) Rezultatet nga Zgjedhjet për President të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 2) Rezultatet nga Zgjedhjet për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Derisa nuk përfundohet me përmbledhjen e rezultateve për President, KZ nuk e hap kutinë e votimit për zgjedhjen e deputetëve.

Pasi që vendvotimi të mbyllet, Këshilli zgjedhor vepron në këtë mënyrë:

## A) PËRPUTHJA E FLETËVOTIMEVE

- 1) KZ i numëron nënshkrimet dhe gjurmët e gishtërinjëve të votuesve në ekstraktin e Listës zgjedhore. Në këtë mënyrë përcaktohet NUMRI I PËRGJITHSHËM I ZGJEDHËSVE TË CILËT KANË VOTUAR. Ky numër shënohet në Procesverbal (Formulari 16).
- 2) NUMËROHEN FLETËVOTIMET E PAPËRDORURA. Numri i tyre verifikohet në këtë mënyrë:

Numri serik i fletëvotimit të fundit të papërdorur	-	Numri serik i fletëvotimit të parë të papërdorur	+ 1 =	Numri i fletëvotimeve të papërdorura
<i>Пример:</i>				
35700	-	35500	+ 1 =	201

Ky numër evidentohet në procesverbal (Formulari numër 16), pjesa IV në rubrikën përkatëse.

MOS HARRONI, gjatë kësaj procedure në numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të papërdorura t'i shënoni fletëvotimet e papërdorura nga votimi i personave të sëmurë ose të pamundur!

- 3) Fletëvotimeve të papërdorura:

- ➔ u shkëputet këndi i poshtëm i djathtë,
- ➔ futen në zarf të veçantë i cili mbyllet dhe vulozet,
- ➔ së bashku me ato në zarf vendoset edhe koçani nga fletëvotimet e përdorura,



- ➔ në zarf ngjitet etiketë në të cilën shënohet numri i vendvotimit, numri total i fletëvotimeve të papërdorura dhe numrat serik të fletëvotimit të parë dhe të fundit që nuk janë përdorur..



- 4) NUMRI I FLETËVOTIMEVE TË SHFRYTËZUARA (PËRDORURA) në procesin e votimit përfitohet me këtë formulë:

Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pranuara	-	Numri i fletëvotimeve të përdorura	=	Fletëvotimet e përdorura (shfrytëzuara)
<i>Пример:</i>				
800	-	201	=	599

Numri i fletëvotimeve të përdorura duhet PATJETËR të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të cilët kanë votuar.

Nëse këto numra nuk janë të barabartë, Këshilli zgjedhor këtë e shënon në Procesverbal (Formulari 16) në rubrikën „ kontrollimi i dytë pas mbylljes së vendvotimit”) dhe në Ditar si dhe për këtë e njofton Komisionin komunal zgjedhor.

#### B) HAPJA E KUTIVE TË VOTIMIT

Kryetari i Këshillit zgjedhor i hap kutitë e votimit sipas rradhitjes të përcaktuar në këtë kapitull.

Kryetari i KZ-së para hapjes së kutisë së votimit:

- kontrollon nëse numrat e shiritave plastike të sigurisë janë të njëjtë me ato që është mbyllur kutia e votimit gjatë hapjes së vendvotimit dhe të cilat janë shënuar në Ditar
- nëse përputhen numrat e shiritave, këtë fakt e shënon në ditar dhe vazhdon me hapjen
- nëse numrat e shiritave nuk përputhen, këtë fakt e shënon në procesverbal (Formularin 16), pjesa VI - Vërejtje dhe për këtë e njofton KOMISIONIN KOMUNAL ZGJEDHOR dhe vazhdon me procedurën e përmbledhjes dhe vërtetimit të rezultateve.

Kryetari i Komisionit zgjedhor e hap kutinë e votimit.

#### B) NUMËRIMI I VOTAVE

1) Pasi që të hapet kutia, me short përcaktohet një nga anëtarët e Këshillit zgjedhor i cili:

- do të nxjerrë një nga një fletëvotimet nga kutia dhe
- të hapura do t’ja dorëzojë Kryetarit të Këshillit zgjedhor.

2) Kryetari i Këshillit zgjedhor ua tregon fletëvotimin të gjithë të pranishmëve.



3) KZ verifikon nëse fletëvotimi është i vlefshëm, i paplotësuar ose i pavlefshëm dhe e për listë të kandidatëve është votuar. Për këtë qëllim, në tavolinën e punës formohen grumbuj përkatës të fletëvotimeve.

Fletëvotimi i vlefshëm:

Fletëvotimi është i vlefshëm nëse është në pajtim me nenin 110 të Kodit zgjedhor: „Zgjedhësi votimin e realizon në atë mënyrë **duke rrethuar numrin rendor** para parashtruesit të listës, përkatësisht numrin rendor para kandidatit për të cilin është përcaktuar të votojë dhe fletëvotimin e paluar e vendosë në kutinë e votimit.“:



*Fletëvotim i vlefshëm*

Me përjashtim, për fletëvotim të vlefshëm merret edhe ai fletëvotim prej së cilës **në mënyrë të sigurtë dhe pamëdyshje mund të vërtetohet se për listë të kandidatit ka votuar zgjedhësi.**

Mënyra e sigurtë dhe pa hamendje e shprehjes së vullnetit të zgjedhësit paraqet fletëvotimi në të cilin zgjedhësi, në vend të numrit rendor para parashtresit të listës, e ka rrethuar emrin e parashtresit të listës, emrin dhe mbiemrin e kandidatit (bartësin e listës) ose simbolin e parashtresit të listës.



#### *Fletëvotime të vlefshme*

##### Fletëvotimi është i pavlefshëm:

- Nëse janë rrethuar më tepër lista të kandidatëve,
- Nëse është shënuar me forma dhe simbole të tjera, përveç rrethimit,
- Nëse është zhgarravitur pjesërisht ose tërësisht,
- Nëse vula në fletëvotim nuk është e ngjajshme me numrin e vendvotimit përkatës ku votohet,
- Nëse fletëvotimi nuk ka vulë në pjesën e përparme,
- Nëse është e rrethuar me marker me çfarëdo ngjyre,
- Nëse është e rrethuar me stilolaps të ngjyave tjera, përveç ngjyrës së kaltërt,
- Nëse nuk është plotësuar.





Fletëvotim i pavlefshëm



Fletëvotim i pavlefshëm




Fletëvotim i pavlefshëm

4) Fletëvotimi vendoset në grumbullin përkatës, i kthyer me fytyrën për së larti.

5) Procedura përsëritet derisa nuk nxirren nga kutia e votimit të gjitha fletëvotimet.

6) Nëse në kuti ka fletëvotime të **PAPLOTËSUARA KZ menjëherë:**

- ➔ I zhgarravitë në tërë gjatësinë, dhe
- ➔ I vendos në grumbullin e fletëvotimeve të pavlefshme.



7) Nëse më 8 maj 2024 në kutinë e votimit për zgjedhjen e Presidentit ka fletëvotime për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend, dhe anasjelltas, kryetari i KZ-së këtë do ta shënojë në ditarin për evidentimin e ngjarjeve, ndërsa fletëvotimi do të përmblihet në fletëvotimet tjera nga kutia përkatëse.

8) Të gjitha fletëvotimet e PAVLEFSHME vendosen në një zarf të veçantë në të cilin shkruhet “ fletëvotime të pavlefshme”.

Nëse ndonjëri nga përfaqësuesit e autorizuar ose anëtar i këshillit zgjedhor kundërshton me gojë për ndonjë fletëvotim të pavlefshëm, KZ-ja në lidhje me këtë vërejtje voton dhe vendosë, ndërsa këtë rast e shënon në Procesverbal (Formulari nr.16), pjesa VI.

## KONFIRMIMI I VOTAVE TË FITUARA SIPAS LISTËS SË KANDIDATËVE

- Fletëvotimet nxiren një nga një dhe konfirmohen se për cilën listë është votuar
- Vota e dhënë regjistrohet në një fletë të thjeshtë
- Fletëvotimet nga të gjitha grumbujt e radhitura numërohen edhe njëherë
- Rezultatet shënohen në Procesverbal (Formularin nr.16).

**GJATË PËRSËRITJES SË PROCEDURËS PËR ÇDO KUTI TË VOTIMIT, DUHET TË KINI KUJDES PËR MATERIALIN ZGJEDHOR I CILI PARAPRAKISHT ËSHTË PËRPUNUAR!**

**PËRKATËSISHT RËNDËSI TË VEÇANTË T’I KUSHTONI SIGURIMIT TË FLETËVOTIMEVE TË NUMËRUARA!**



## G) PLOTËSIMI I PROCESVERBALIT

KZ përpilon procesverbale të votimit, përmbledhjes dhe vërtetimit të rezultateve në formularët e vetëm:

- ✓ **Formulari numër 16-a**, për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe
- ✓ **Formulari numër 16**, për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**Këto formularë i pranoni së bashku me materialin e besueshëm zgjedhor, ata janë të përshkruar dhe të vërtetuar me vulë të Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. Formularët, bashkë me udhëzimet e veçanta për plotësimin e tyre mund ti gjeni në faqen e internetit të KSHZ-së. LEXONI ME KUJDES UDHËZIMET PARA SE TË FILLONI ME PLOTËSIMIN E PROCESVERBALEVE!**

KZ merr VETËN NJË EKZEMPLAR të formularëve origjinal nr. 16 me vulë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**Ruajini me kujdes!**

Procesverbalin :

- ➔ e plotëson kryetari i KZ-së,
- ➔ e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e KZ-së, dhe
- ➔ i dorëzohet personalisht në dorë kryetarit KOMISIONIT KOMUNAL ZGJEDHOR.

Për plotësimin e Procesverbalit:

Në rastet e GABIMEVE GJATË PLOTËSIMIT TË PROCESVERBALIT Këshilli zgjedhor:

- 1) me stilolaps i vë vijë fjalës, respektivisht numrit të gabuar, me çrast duhet të ngel edhe më tej i lexueshëm,
- 2) me stilolaps plotësohet e dhëna e saktë,
- 3) përkaj korrigjimit nënshkruhet kryetari i Këshillit zgjedhor dhe vihet vula e Këshillit zgjedhor.

Пример:

~~55~~

57

XXX

Погрешен број

Точен податок

Печат и потпис на претседателот на ИО

## D) PASI QË T'Ë NËNSHKRUAJË PROCESVERBALET NUMËR 16-a, GJEGJËSISHT 16, KËSHILLI ZGJEDHOR:

- Plotëson dhe i nënshkruan kopjet e karbonizuara të Formularëve numër 16-a, gjegjësisht 16.

- Këshilli zgjedhor, secilit përfaqësues të parashtruesve të listës së kandidatëve dhe secilit vëzhgues të akredituar i cili është i pranishëm në vendvotim i jep nga një kopje të karbonizuar të Procesverbaleve (Formulari numër 16-a dhe 16).
- Plotëson Procesverbalin për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari numër 20).
- Në vend të dukshëm të objektit ku është vendosur vendvotimi shfaq (ngjet) nga një kopje të karbonizuar të pjesës tabelare nga Formularët numër 16-a dhe 16.

VINI RE: Kopjet vihen në vende ku edhe pas mbylljes së vendvotimit qytetarët e interesuar të mund të informohen me rezultatet e votimit. Pra vendoset në derën e hyrjes së obkektit ose shkollës. Kjo është me rëndësi që të garantohet transparencja e procesit zgjedhor dhe paraqet udhërrëfyes të rëndësishëm për njohjen dhe ndjekjen e procedurave.




## 8.10. PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

Më 8maj, kur njëkohësisht do të mabhen Zgjedhjet Parlamentare dhe rrethi i dytë i Zgjedhjeve Presidenciale, fillimisht FILLONI ME PAKETIMIN E MATERIALIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT.


Në thes plastik të tejdukshëm për transportin e materialit të besueshëm, në të cilin është i vendosur ngjitës me emrin e komunës, llojin e zgjedhjeve dhe numrin e vendvotimit, paktohen:

1. Zarfi i vulosur i bardhë mat në të cilin paraprakisht janë vendosur zarfi me fletëvotimet e vlefshme dhe zarfi me fletëvotimet e pavlefshme);
2. Zarfi i vulosur me fletëvotimet e papërdorura dhe blloku (koçani) i fletëvotimeve të përdorura;
3. Ekstrakti i Listës zgjedhore dhe ekstrakti i veçantë i Listës zgjedhore (nëse ekziston).;
4. Ditari për evidentim të ngjarjeve dhe raportet e printuara nga PIBV.



Në të njëjtën mënyrë vazhdoni me paketimin e MATERIALIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE NË KUVEND.

5. PROCESVERBALET ORIGJINALE nga përmbledhja e rezultateve (Formularët numër 16) dhe Procesverbali për dorëzimin e materialit zgjedhor (Formulari numër 20) dorëzohen te komisioni komunal zgjedhor në ZARF TË VEÇANTË dhe i dorëzohen kryetarit të Komisionit komunal zgjedhor.



6. Për pajisjen për identifikimin biometrik të votuesve SHIKO KAPITULLIN 7.5
7. UV llamba dhe vula me numrin e vendvotimit i dorëzohen në dorë personit të autorizuar në Komisionin komunal zgjedhor.
8. Kutitë e votimit gjithashtu kthehen dhe u dorëzohen Komisionit komunal zgjedhor.

Materialin zgjedhor të votimit në Komisionin komunal zgjedhor e dorëzon Kryetari i KZ-së në shoqërim të anëtarëve të Këshillit zgjedhor dhe përfaqësuesve të interesuar të parashtrurve të listave.

Policia e siguron Këshillin zgjedhor gjatë transportit të materialeve deri te Komisioni komunal zgjedhor, nëse Këshilli e kërkon këtë.

# 1.

## NDALESA PËR PËRDORIMIN E CELULARIT OSE FOTOAPARATIT PËR FOTOGRAFIMIN E FLETËVOTIMIT



### 9. NDALESAT NË VENDVOTIM

#### NDALESA PËR PËRDORIMIN E CELULARIT DHE FOTOAPARATIT PËR FOTOGRAFIMIN E FLETËVOTIMIT



Ndalohet fotografimi i fletëvotimit me celular ose fotoaparate. Përfaqësuesit e autorizuar të parashtresve të listave, vëzhguesit dhe votuesit në ditën e zgjedhjeve në vendvotim nuk guxojnë të përdorin celularin, fotoaparatin ose pajisje të tjera për fotografimin e fletëvotimit.

Këshilli zgjedhor ka të drejtë që secilin person që nuk i përmbahet kësaj ndalese ta largojë nga vendvotimi.

Çka nëse Këshilli zgjedhor vëren që ndonjë votues e ka fotografuar fletëvotimin?	→	KZ-ja do t'i shënojë të dhënat e votuesit në ditarin për evidentim të ngjarjeve, ndërsa kryetari i KZ-së do ta thërret punonjës të policor.
Si vepron me fletëvotim të fotografuar?	→	Kryetari i KZ-së e lëshon fletëvotimin në kutinë përkatëse për votim dhe i njëjti numërohet me fletëvotimet tjera pas mbylljes së vendvotimit.

#### NDALESA PËR MBAJTJEN E ARMËVE NË VENDVOTIM

Përveç policisë askush nuk guxon të vijë i armatosur në vendvotim.

Policia në vendvotim hyn vetëm në raste kur thirret nga Këshilli zgjedhor dhe kur vëren se seriozisht është prishur rendi dhe qetësia.



#### **NDALESA PËR VOTIM FAMILJAR DHE GRUPOR NË EMËR TË PERSONIT TJETËR**

E drejta e fshehtësisë së votës garantohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshillat zgjedhorë janë ato të cilat janë përgjegjëse për t'i njohur dhe për t'i penguar tentativat për cënimin e fshehtësisë së votës!

**GJATË KOHËS SË VOTIMIT KËSHILLI ZGJEDHOR DUHET QË VOTUESIT T'I SIGUROJË QË TË JETË I VETËM PAS PARAVANIT TË VOTIMIT!**

Votimi familjar dhe grupor dhe votimi në emër të personit tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i ndaluar. Kjo do të thotë shkelje e të drejtës zgjedhore që paraqet bazë të cënimit të fshehtësisë së votës e cila mund të sjellë deri tek prishja e votimit. Me votimin familjar cënohet: fshehtësia e votimit, barazia e drejtës zgjedhore dhe përcaktimi i lirë gjatë votimit.

Ndalesa për votim familjar dhe grupor dhe votimi në emër të tjetrit ka të bëjë me:

- NDALESË që një person të votojë për tjetrin /për persona tjerë (votimi për tjetrin);
- NDALESË që një anëtar i familjes, pas paravanit zgjedhor tju tregojë anëtarëve të tjerë për kë të votojnë (votim familjar);
- NDALESË për të votuar bashkë pas paravanit të votimit dy, grup ose e tërë familja (votim grupor) dhe ngjajshëm.





ИО мора да обезбеди за време на гласањето гласачот да биде сам зад параванот!

Anëtarët e kshillit zgjedhor DUHET t'i indetifikojnë këto fenomene, dhe ato t'i NDALOJNË.

Në rastet e tentativës për votim familjar anëtarët e këshillit zgjedhor kanë për obligim që:

1. Ta ndalojnë tentativën dhe
2. Çdo tentativë ta evidentojnë në Ditarin për evidencën e ngjarjeve
3. Nëse nuk kanë sukses ta ndalojnë tentimin, ndërsa me këtë prishet rendi dhe qetësia në vendvotim e thërrasin policinë.

Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë në denarë për shkelje do ti shqiptohet anëtarit të organit zgjedhor i cili punon në kundërshtim me dispozitat e Kodit zgjedhor.

Gjobë në vlerë prej 750 deri 2.250 euro në kundërvlerë në denarë për shkelje do ti shqiptohet personit fizik i cili voton për më shumë persona ose voton në emër të personit tjetër.

Kodi zgjedhor shkeljet e privatësisë së votimit, si dhe votimin për person tjetër i merr si bazë për prishjen e votimit në vendvotim.

## 10. BASHKËPUNIMI ME POLICINË

Këshilli zgjedhor kujdeset për mbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotim. Ai mundet të kërkojë ndihmë nga policia për rivendosjen e rendit në vendvotim.

Policia e siguron rendin në vendvotim, në objektin në të cilin gjendet vendvotimi dhe e siguron qasje deri në vendvotim (hapësirën ku votohet).

Policia e siguron pandërprerë vendvotimin nga ora 6.00 deri në ora 19.00, respektivisht deri në përfundimin e votimit. Pas përfundimit të votimit Policia e siguron transportin e materialit zgjedhor deri në KOMISIONIN KOMUNAL ZGJEDHOR.

Nëse kërkohet intervenimi i policisë në vendvotim, rasti vërtetohet dhe regjistrohet në Formular!

Policia mund të vijë në vendvotim vetëm nëse thirret nga:

- Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZ-së
- Në raste të veçanta, nëse kryetari dhe zëvendëskryetari i KZ-së janë të penguar dhe të njejtit nuk mund të thërrasin policinë, atëherë këtë mund ta bëjë njëri nga anëtarët e KZ-së.

Thirrja e policisë bëhet gojarisht, me shkrim, me anë të telefonit ose në ndonjë mënyrë tjetër. Këshilli zgjedhor, për çdo intervenim të policisë njofton Komisionin komunal zgjedhor dhe plotëson formularin e veçantë për verifikimin e nevojës së thirrjes së policisë.

Këshilli zgjedhor në hapësirën ku votohet në vendvotim, mund të thërret policinë për intervenim për shkak të:

- Prishjes së rendit dhe qetësisë në vendvotim – deri në rivendosje
- Largimit të personave të pa aurtorizuara nga objekti dhe hapësira e vendvotimit
- Në raste të veçanta, e largon kryetarin dhe zëvendëskryetarin ose anëtarin e Këshillit zgjedhor nëse e prishin rendin dhe qetësinë në vendvotim, nëse kjo është e nevojshme për rivendosjen e rendit
- Largimin e të gjithë personave të pa autorizuar nga vendvotimi dhe nga objekti ku është vendvotimi pas mbylljes së vendvotimit, për të siguruar numërimin dhe përmbledhjen e papenguar të rezultateve

Policia Këshillin zgjedhor e siguron deri në dorëzimin e procesverbalit dhe materialit zgjedhor në KOMISIONIN KOMUNAL ZGJEDHOR, nëse ajo kërkohet nga ana e KZ-së.

Nëse policia nuk i përgjigjet kërkesës së këshillit zgjedhor për intervenim, ndërsa për të ka pasur nevojë dhe ka ndikuar mbi zbatimin e votimit në vendvotim, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, përmes detyrës zyrtare ose përmes kundërshtimit të parashtruar, me Aktvendim E ANULON VOTIMIN në këtë vendvotim.